



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

### PROCES VERBAL

**Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Korrik 2024**

**Data 29.07.2024 ora 15:00.**

**Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.**

#### **Rendi i dites:**

- 1.Projekt vendim për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës Znj.Sanije Reshit Salja.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2024.
- 3.Projekt vendim për ndryshim emërtimi të segmentit të rrugës “Osman Kodranjeci”, fshati Mjedë, Bashkia Vau Dejës në rrugën “Jeraj” fshati Mjedë, Bashkia Vau Dejës.
- 4.Projekt vendim për ndryshim emërtimi të segmentit të rrugës “Don Nikolli”, në “Gjerardo Tushi”, lagja e pallateve, qyteti Vau Dejës.
- 5.Projekt vendim për një shtesë në Vkb nr.41 datë 27.06.2022 “Për miratimin e Rregullores së Brëndshme për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike” si dhe për hapjen e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia Vau Dejës.
- 6.Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.
- 7.Projekt vendim për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Vau Dejës.
- 8.Projekt vendim për miratimin e përfitimit të vlerës së subvencionit të qirasë për Znj.Tone Pjetraj në programin e strehimit “Subvencionit të qirasë në tregun e lirë”.
- 9.Të ndryshme.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Korrik 2024, u zhvillua me datë 29.07.2024 ora 15.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 17 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 16 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës Znj.Sanije Reshit Salja.

Z. Ervis Shimaj realaton për këshilltarët se bazuar në vendimin nr.67 datë 04.07.2024 të KQZ Tiranë për plotesimin e vakances në Këshillin Bashkiak Vau Dejes, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë Znj.Sanije Reshit Salja si pasojë e dorëheqjes nga anëtarë i këshillit Znj.Paola Pleshaj, si dhe në propozimin e komisionit të mandateve, ju propozoj miratimin e mandatit si anëtare e këshillit bashkiak Vau Dejës për Znj.Sanije Salja.

Hidhet në votim propozimi: Miratohet me 16 vota Pro.

Z.Ervis Shimaj fton Znj. Sanije Salja për të bërë betimin, e cila betohet pas leximit të formules së betimit.

Pas votimit të pikes së parë,Z.Ermir Tahiri largohet nga mbledhja, mbesin prezent 16 këshilltarë.

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Ilda Prendi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se , bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Qershor 2024, te perfitojne 140 familje, me 473.922 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Qershor 2024 janë shpallur fitues, 1.026 familje, me fond 7.905.695 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 474.341 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për ndryshim emërtimi të segmentit të rrugës “Osman Kodranjeci”, fshati Mjedë, Bashkia Vau Dejës në rrugen “Jeraj” fshati Mjedë, Bashkia Vau Dejës.



Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, znj.Dorina Lekaj-juriste pranë zyres zyres urbanistikes, Bashkia Vau Dejës, e cila relatton përpara këshilltarëve se disa banorë të fshatit Mjedë kanë paraqitur një kërkesë ,te konfirmuar edhe nga kryetari i fshatit Mjedë, per ndryshim emertimi te segmentit rrugorë në fshatin e tyre, kane spjeguar se emertimi aktaul i ketij segmenti rrugor nuk ka lidhje me emrin e rruges sepse ato e njohin për rruga Jeraj.Për këtë arsye kërkojmë miratimin e këtij projekt vendimi.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Samed Hasmeqaj-këshilltarë, pyet: Si dhe kush i ka vendosur këto emertime më përpara?

Znj.Dorina Lekaj përgjigjet: Më përpara të gjitha emertimet e rrugeve jane bërë pa u pyetur banorët per efekt të dixhitalizimit te adresave, ndersa sot, banorët kërkojnë që segmentet e rrugeve të fshatit te jenë me emertime që kanë kuptim.

Pyetje tjera nuk ka. Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 16 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:**

Projekt vendim për ndryshim emërtimi të segmentit të rrugës “Don Nikolli”, në “Gjerardo Tushi”, lagja e pallateve, qyteti Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, znj.Dorina Lekaj- juriste pranë zyres zyres urbanistikes, Bashkia Vau Dejës, e cila relatton përpara këshilltarëve se disa banorë të Qytetit Laç Vau Dejes, kanë kërkuar që segmenti prej 125 m, ti vendoset emri “Gjerardo Tushi”,pra një pjese të rruges e cila aktualisht emertohet me emrin “Don Nikolli” duke arsyetuar se ky propozim vjen si pasojë e kontributit të vazhdueshëm të prinderve të të ndjerit në fushen e arsimit si dhe në fushen e ushtrisë.Gjithashtu i ndjeri Gjerardo Tushi, pas kryerjes së studimeve të larta në Universitetin e Mjeksisë, ka dhënë kontributin e tij në fushen e mjeksisë për banorët e zonës.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Frano Prenga – këshilltarë, pyet:A është ndryshuar emertimi i gjithë segmentit rrugor?

Znj.Dorina Lekaj përgjigjet: Jo, propozohet vetem per nje segment te kesaj rruge, prej 125 meter.

Pyetje tjera nuk ka. Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 16 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për një shtesë në Vkb nr.41 datë 27.06.2022 “Për miratimin e Rregullores së Brëndshme për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike” si dhe për hapjen e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia Vau Dejës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, znj.Dorina Lekaj-juriste pranë zyres zyres urbanistikes, Bashkia Vau Dejës, e cila relatton përpara këshilltarëve se është ndjekur rruga ligjore per hartimin e projekt vendimit.

Në projekt vendim vleresohet se është e domosdoshme që krahas hapjes së vendparkimeve në fshatin Koman, kërkesë e ardhur nga administratori i Nj.A Temal për efekt të zhvillimit dhe krijimit te kushteve për sezonin turistik, për vizitorët, duhet te behet nje nderhyrje ne rregulloren e brendshme per shfrytezimin e hapsirave publike, miratuar me vkb nr.41/2022, konkretisht per nje shtesë lidhur me menaxhimin e vendparkimeve sezonale me bileta dhe vendparkimeve pa pagese për banorët e ketij fshati te cilat do te menaxhohen nga Nj.A.Temal.Pra projekt vendimi konsiston ne shtesen e një dispozite te kesaj rregullore të miratuar ne vitin 2022 nga Këshilli Bashkiak Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Besmir Kapaj-këshilltarë, pyet: A janë vendosur tarifa?

Znj.Dorina Lekaj përgjigjet: Për tarifaf, është pergjegjes derjtoria e shërbimeve, por tarifaf jane te vendosura në VKB per taksat dhe tarifaf te miratuara ne fundin e vitit 2023.

Pyetje tjera nuk ka. Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 16 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë rendit të ditës:**

Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, znj.Elsa Tanushi-Drejtore e Financë Buxhetit, Bashkia Vau Dejës e cila relatton për këshilltarët se projekt vendimi i paraqitur per miratim ka te beje vetem me ndryshim kapitulli 04(TVSH) në kapitullin 05(të ardhuar), gjë e cila rregullon kryerjen e pagesave të TVSH-ve te faturave të operatoreve ekonomik sipas marreveshjes në fuqi që është bërëndermjet bashkisë dhe bashkimit europian, per te cilat bashkia ka rene dakort te paguajë tvsh-te e faturave te operatoreve ekonomik me te ardhurat e veta.Për hartimin e ketij projekt vendimi është zbatuar me korrektesi baza ligjore.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Pyetje nuk ka. Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 16 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e tavaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Vau Dejës.



Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, znj.Elsa Tanushi-Drejtoresh e Financë Buxhetit, Bashkia Vau Dejës e cila raporton për këshilltarët se tavanet buxhetore të projekt buxhetit për vitin 2025 dhe tavanet e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 janë hartuar konform ligjit dhe se ky proces ka hapat e vet ligjor, deri në miratimin e taveveve përfundimtare të cilat miratohen në muajin Dhjetor të këtij viti, për buxhetin e vitit 2025 dhe PBA 2025-2027. Procesi ku jemi aktualisht, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimin e të ardhurave dhe burimeve gjithsejt dhe përcakton objektivat se përse do haxhohen ato dhe kostot e nevojshme dhe llojin e sejcilit shërbim që do ofrohet. Pra kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Të gjitha hollësitë janë të pasqyruara në materialin me të cilin jeni të pajisur.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Pyetje nuk ka. Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin. **Miratohet me 16 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon pikën e tetë rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e përfitimit të vlerës së subvencionit të qirasë për Znj.Tone Pjetraj në programin e strehimit “Subvencionit të qirasë në tregun e lirë”.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, z.Edmond Gjeçaj-pefaqësues i zyrës strehimit, Bashkia Vau Dejës, i cili raporton për këshilltarët se komisioni i strehimit në mbledhjen e datës 12.07.2024 ka shqyrtuar dokumentacionin e plote dhe kontratën noteriale për znj.Tone Pjetraj, e cila aktualisht ndodhet në kushte si e pastrehë. Duke parë se znj.Tone Pjetraj ndodhet në kushtetë përfitimit të subvencionit të qirasë, kemi propozuar që të jetë përfituese e subvencionit të qirasë, kjo konform ligjit dhe në zbatim të Vkb 47/2024.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Pyetje nuk ka. Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin. **Miratohet me 16 vota Pro.**

#### **Pika nëntë, të ndryshme:**

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për të parashtruar problematikat dhe shqetësimet që kanë hasur në zonat e tyre, meqenëse prezent në mbledhje është edhe zv.kryetarja e Bashkisë Znj.Aleksandra Gjoni.

Z.Mark Bisha ngre shqetësim për disa kosha të mbeturinave të cilat janë hequr nga lagja pallate, qyteti Laç, kërkon arsyen.

Znj. Aleksandra Gjoni përgjigjet se ky shqetësim do përcillet drejtorisë së shërbimeve.

Z,Samet Hasmeqaj pyet se pse i është hequr ndihma ekonomike z.Saurel Ahmeti nga fshati Mjedë.

Znj. Aleksandra Gjoni përgjigjet se do vihet në dijeni sektori i ndihmes ekonomike.



Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës mbledhjen e datës 29.07.2024 e deklaroi të mbyllur pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera.

**Mbajtësi i Protokollit**

**Sekretari Këshillit**

**Ardian CELEPIJA**



Këshilltarët:

*Ervis Shinoj*  
*Enver Ahmeti*  
*Neli Topkallaj*  
*Enver Kalo*  
*Omela Lleshi*  
*Larye Sejdi*  
*Majlinda Kabeza*